



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-024

Prishtinë, më 21 dhjetor 2021, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 DHJETOR 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi dhe Besnik Tahiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 8 dhe 15 dhjetor 2021,
2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 18, 19, 22, 23 nëntor dhe 6 dhjetor 2021,
3. Pikat e papërfunduara të seancës plenare, e mbajtur më 13 dhjetor 2021,
4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 8 dhe 15 dhjetor 2021

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 8 dhe 15 dhjetor 2021.

2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 18, 19, 22, 23 nëntor dhe 6 dhjetor 2021,

3. Pikat e papërfunduara të seancës plenare, më 13 dhjetor 2021,

Kryesia nuk diskutoi e as nuk vendosi për vazhdimin e seancave plenare të lartshënuara nga pikat 2 dhe 3.

* * *

Kryetari i njoftoi të pranishmit se seanca plenare, sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, të marrë në seancën plenare, të mbajtur më 17 dhjetor 2021, do të mbahet të enjten, më 23 dhjetor 2021, në orën 10:00, me pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-067 për inspektimet.

* * *

4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me datën e mbajtjes së seancës plenare të radhës dhe pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të premtën, më 24 dhjetor 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright,*
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin e pjesëtareve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse,*
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-096 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Programit - Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit,*
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-100 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian, në njërën anë, dhe Kosovës, në anën tjetër, për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit Horizon Europe - Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin,*
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-105 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa kreative (2021-2027),*
- 9. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,*
- 10. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,*
- 11. Propozimi i dy (2) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese,*
- 12. Zgjedhja e dy (2) drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, “NP KOSTT”,*
- 13. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave,*
- 14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme,*
- 15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-021 për tregti me jashtë,*
- 16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-099 për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore,*
- 17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë,*
- 18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,*
- 19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-079 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-85 për peshkatari dhe akuakulturë,*

20. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/5 i Kosovës për farërat,*
21. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-085 për bujqësi organike,*
22. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-082 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve,*
23. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat,*
24. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-084 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.02/L-53 për gjuetinë,*
25. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-085 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/13 për materialin fidanor,*
26. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-086 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-114 për pasurimin e miellit,*
27. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-087 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 04/L-040 për rregullimin e tokës,*
28. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-111 për bletari,*
29. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-089 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/10 për plehrat artificiale,*
30. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-090 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-10 për përkujdesjen ndaj kafshëve,*
31. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/21 për veterinarinë,*
32. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-029 për Inspektoratin Bujqësor,*
33. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-093 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve,*
34. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-094 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-9 për ujitjen e tokave bujqësore,*
35. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-095 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve,*
36. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,*
37. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-064 për tokën ndërtimore,*
38. *Debat parlamentar në lidhje me krizën energjetike në Kosovë.*

Në lidhje me pikat nr. 7 dhe nr. 8 të lartshënuar të rendit të ditës për seancën plenare, kryetari tha se shqyrtimi i dy projektligjeve duhet të bëhet me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, pasi të njëjtat janë proceduar nga Komisioni Funkcional para afatit të paraparë.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete për debat parlamentar në lidhje me Kancerin e Gjirit

Kryesia e shtyu përsëri shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

2. Kërkesa e kryetarit të GP të AAK-së, Besnik Tahiri, mbështetur nga gjashtë (6) deputetë tjerë të këtij grupi, për debat parlamentar në lidhje me ngritjen enorme të çmimeve

Kryesia e shtyu përsëri shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

3. Kërkesa e Komisionit për Integrim Evropian për debat parlamentar lidhur me Raportin për Vending për vitin 2021

Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

4. Kërkesa e deputetit Ramush Haradinaj, mbështetur nga gjashtë (6) deputetë tjerë të GP të AAK-së, për debat parlamentar në lidhje me krizën energjetike në Kosovë për shkak të reduktimeve dhe rikthimit të territ në Republikën e Kosovës

Kryesia, debatin parlamentar në lidhje me krizën energjetike në Kosovë e radhiti në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 24. 12. 2021.

5. Kërkesa e znj. Fatmire Kollçaku, kryetare e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm për raportimin e Qeverisë së Kosovës në Kuvend rreth “Progresit në përfshirjen e objektivave të zhvillimit të Qëndrueshëm në legjislacion, politika dhe buxhet”

Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bahrim Shabani për kompensimin e pagës kalimtare nga Legjislatura VI

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa nr. 08/849/Do-459, datë 9. 11. 2021, e deputetit Bahrim Shabani për kompensimin e pagave kalimtare për muajt: prill, maj dhe qershor të vitit 2020, pas përfundimit të Legjislaturës VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hagë (Holandë)

Kryesia e shtyu përsëri shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

8. Kërkesa për formimin e Grupit të Miqësisë me Tajvanin

Kryesia, pas diskutimeve, e shtyu shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar.

9. Përgjigja lidhur me njoftimin e z. Mehmet Krasniqi për pezullimin e detyrave dhe përgjegjësi si anëtar i Komisionit për Ndihmë Shtetërore

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me pezullimin e detyrave dhe përgjegjësi të anëtarit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, Mehmet Krasniqi, me 4 vota për, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga tre (3) kryetarët e komisioneve parlamentare: Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike; Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, që ta shqyrtojnë lëndën e z. Mehmet Krasniqi në lidhje me pezullimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij nga pozita e anëtarit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

10. Raporti i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Paris (Francë)

Kryesia është njoftuar me shkrim nëpërmjet raportit nga Delegacioni i Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Paris (Francë), nga data 2 - 3 dhjetor 2021.

* * *

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e udhëtimit zyrtar

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri, mori këtë:

V E N D I M

1. Delegacionit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili do të përbëhet prej gjashtë (6) deputetëve të Kuvendit, u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri, prej datës 12 - 14 janar 2022.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për Delegacionin prej gjashtë (6) deputetëve të Kuvendit, në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesa për aprovimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në ceremoninë e Seb-i Arus me rastin e 748. Shen Mevlana në Turqi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga GP Multietnik: Bekim Arifi, Enis Kervan, Fridon Lala, Erxhan Galushi dhe Bahrim Shabani u aprovohen shpenzimet e udhëtimit me veturë zyrtare (derivatet) dhe avanci në shumë prej 500€, për pagesat e sigurimit të veturës gjatë rrugës dhe të shpenzimeve tjera lidhur me pjesëmarrjen e tyre në ceremoninë e Seb-I Arus me rastin e 748. Shen Mevlana, në Turqi, prej datës 25 - 29 dhjetor 2021, sipas kërkesës nr. 08/1216/Do-562, datë 21. 12. 2021.

3. Kërkesa për emërimin e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryesia, pasi diskutoi për emërimin e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohet Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2022, në këtë përbërje:

1. Saranda Bogujevci, anëtare dhe kryesuese e Delegacionit, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.
2. Arben Gashi, anëtar, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.
3. Enis Kervan, anëtar, nga Grupi Parlamentar “Multietnik”.
4. Ariana Musliu Shoshi, zëvendës-anëtare, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.
5. Besnik Tahiri, zëvendës-anëtar, nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.
6. Igor Simiq, zëvendës-anëtar, (nga GP i Listës serbe).

4. Kërkesë e deputetit Arben Gashi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arben Gashi i rimbursohen shpenzimet për Test COVID-19 në shumën prej 50,01 euro, lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Paris (Francë), nga data 6 - 7 dhjetor 2021.

5. Raport lidhur me pjesëmarrjen në takimin e Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci si dhe në Komitetin për Çështje Ligjore dhe të Drejta e Njeriut, mbajtur më 6 - 7 dhjetori 2021, në Paris (Francë)

Kryesia është njoftuar me shkrim nëpërmjet raportit nga anëtari i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Arben Gashi, lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Paris (Francë), nga data 6 - 7 dhjetor 2021.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 16:35 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale